



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrat e Publikë, nenin 5 paragrafi c të Ligjit numër 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, si dhe nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Specialistë të Arsimit
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Njësia:	Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitave:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Data e njoftimit:	25.10.2022
Afati për aplikim:	25.11.2022 – 05.12.2022
Numri i referencës:	01-111/01-24076

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Të realizoj plan programin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e punës;
- b. Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- c. Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- d. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurrikulare;
- e. Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- f. Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- g. Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

4. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Statusi	Vendi i punës
1.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e fizikës me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dëshmorët e Kombit”
2.	Një (1) edukatore për klasën parashkollor me 10 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Bajram Sadriu”
3.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e historisë me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “8 Dëshmorët”
4.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 16 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Kongresi i Manastirit”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e edukatës fizike me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	
	Një (1) edukatore për klasën parashkollor	Vend i lirë	
5.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 17 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Kongresi i Manastirit” dhe SHFMU “Pjeter Bogdani”
6.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Zef Lush Marku”, SHFMU “Engjëll Gjoni” dhe SHFMU “Hamëz Cena”
7.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Bajram Sadriu”, SHFMU “Zenel Sadiku”, SHFMU “Sylejman Vokshi” dhe SHFMU “Dy Dëshmorët”
8.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 9 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “8 Dëshmorët” dhe SHFMU “Jahë Salihu”
9.	Një (1) mësimdhënës për lëndën histori – edukatë qytetare me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Hamëz Cena”
10.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e historisë me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Mazllum Këpuska”
11.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 20 + 4 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “At Gjergj Fishta”
12.	Një (1) mësimdhënës për programin fillor.	Zëvendësim	SHFMU “Haxhi Hoti”
13.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 12 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Pjeter Bogdani”
14.	Një (1) mësimdhënës për programin fillor.	Zëvendësim	SHFMU “Rilindja”
15.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e	Zëvendësim	SHFMU “Emin Duraku”

	historisë me 16 orë mësimi në javë.		
16.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e sociologjisë me 12 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHML Gjumnazi “Hajdar Dushi”
17.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e ekonomisë me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHMLE “Kadri Kusari”
18.	Një (1) instrktor për modulet e praktikës profesionale të energjetikës (<i>tension i lartë</i>) me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë 26.12.2022	SHMLT “Nexhmedin Nixha”
19.	Një (1) instrktor për modulet e praktikës profesionale të makinerisë me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë 03.04.2023	SHMLT “Nexhmedin Nixha”

5. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimi* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga “UÇK” numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- Rezymeja personale (CV);
- Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të noterizuara (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*);

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Testimi me shkrim
- Intervistë

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

9. Sqarime shtesë:

- Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.